



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1920/1 prot.

Tiranë më 16.12.2019

Lënda: Kthim përgjigje

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u njoh me kërkesën tuaj për mendim me nr.22121/1 Prot., datë 04.12.2019.

Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se sipas pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, parashikohet se: "Të dhëna personale" është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social". Sipas këtij parashikimi, subjekt i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale janë vetëm personat fizik/ individët dhe nuk përfshihen personat juridikë (donatorë).

Sa më sipër, për ato të dhëna të cilat në kuptim të ligjit janë të dhëna personale mund të publikohen vetëm në rastin kur përmbushin njërin nga kriteret ligjore të parashikuara në nenin 5 dhe 6, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Publikimi i listës së individëve që kanë dhuruar në Thesarin e Shtetit si ndihmë për dëmet e shkaktuara në tërmetin e 26 nëntorit, nëse nuk ka një detyrim ligjor për publikim, mund bëhet vetëm pas marrjes së pëlqimit të subjektit të të dhënave personale.

Ndërkohë, në kuptim të pikës 2, të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Në kuptim të këtij ligji, lista e donatorëve dhe shuma e dhuruar nga qeveria, subjekte ekonomike dhe entitete të tjera do të konsiderohet informacion publik, për sa kohë nuk bie ndesh me parashikimet e nenit 17 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohen rastet e kufizimit të së drejtës për informim si dhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në mënyrë të kufizuar.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

